

KERKESEPADI

PER NDRYSHIMIN E VENDIMIT PER DETYRIMIN USHQIMOR

PADITES :

1. Emri..... 2. Mbiemri.....

3. Atësia 4. Adresa e banimit të përhershëm ose te perkohshem.....
.....

5. Nr. i telefonit E-mail.....

(*Kerkesa per nr. e tel dhe adresen e emailit nuk jane te detyrueshme por ndihmojne ne shpejtimin e procesit nepermjet njoftimeve te shpejta*)

Duhet mbajtur ne konsiderate se, pavaresisht nga cilesia qe ka patur personi ne vendimin e meparshem (pra padites apo i paditur) kjo cilesi nuk kushtezon legjitimimin si padites ne kete gjykim. Pra, nese personi ka qene i paditur ne gjykimin e meparshem kjo nuk e pengon ate qe ne kete gjykim te paraqitet si padites, pra si personi qe kerkon ndryshimin e vendimit te meparshem te gjykates.

I PADITUR :

2. Emri..... 2. Mbiemri.....

3. Atësia 4. Adresa e banimit të përhershëm ose te perkohshem.....
.....

OBJEKTI I PADISE :

Ndryshimin e vendimit te formes se prere te gjykates se rrethit gjyqesor ..., nr... date, dhe, ndryshimin e detyrimit ushqimor te te paditurit per femijen e mitur nga shuma ... leke/muaj ne shumenleke/muaj.

Vendimi gjyqesor qe kerkohet te ndryshohet eshte gjithnje vendimi I gjykates se shkalles se pare,

pra, vendimi i gjykates se rrethit gjyqesor edhe sikur nje gjykate me e larte (gjykata e Apelit apo Gjykata e Larte) e kene ndryshuar vendimin e gjykates se shkalles se pare.

BAZA LIGJORE E KERKESES :

Kodi i Familjes, nenet 192- 214,
Kodi i Procedures Civile, nenet 153- 156.

Drejtuar :
GJYKATES SE RRETHIT GJYQESOR

Gjykata kompetente eshte gjykata e rrethit gjyqesor ne territorin e banimit te te paditurit.

PARAQITJA E FAKTEVE;

*Ne kete rubrike duhen sqaruar faktet mbi te cilat bazohet kerkesa.
Faktet qe duhet te sqarohen lidhen me rrethanat per te cilat ligji parashikon ndryshimin e mases se detyrimit ushqimor. Sipas nenit 201 te Kodit te Familjes masa e detyrimit ushqimor kushtezohet nga “ raporti ndermjet nevojave te atij qe e kerkon dhe mundesite ekonomike te atij qe detyrohet”. Per rrjedhoje, faktet duhet te synojne te tregojne rrethanat e ndryshuara qe nga koha e dhenies se vendimit te forms se prere per te cilin kerkohet ndryshimi.
Duhet patur parasysh se termi ligjor “ detyrim ushqimor” eshte me i gjere se vete detyrimi per ushqim dhe perfshin edhe shpenzimet e nevojshme te femijes per edukim, veshje, argetim etj.
Me te zakonshmet jane rrethanat qe lidhen me shtimin e nevojave te femijes per shkak te moshes se rritur.
Por, keto rrethana mund te lidhen edhe me mundesite ekonomike te ndryshuara te te dy prinderve qe detyrohen te kontribuojne ne mirerritjen e femijes.*

ARGUMENTAT LIDHUR ME KUSHTET LIGJORE TE CILAT JUSTIFIKOJNE NDRYSHIMIN E VENDIMIT TE FORMES SE PRERE TE GJYKATES ;

Ne kete rubrike duhet te sqarohet lidhja e fakteve te pasqyruara ne rubriken e mesiperme me kriterin ligjor te ndryshimit te vendimit, rritjen e nevojës se femijes per kontribut me te madh te prindit ne ushqimin e femijes per shkak te rrethanave te ndryshuara ne krahasim me kohen e dhenies se vendimit te formes se prere per te cilin kerkohet ndryshimi.

LISTA E PROVAVE QE I BASHKALIDHEN KERKESES;

Kjo rubrike duhet te permbaje dokumentat qe duhet te paraqiten ne gjykate, te tilla si;
-vendimi gjyqesor i formes se prere per te cilin kerkohet ndryshimi,
-dokumenta te gjendjes civile qe tregojne gjendjen familjare te femijes,
-dokumenta qe tregojne te ardhurat dhe gjendjen ekonomike te te dy prinderve, te tilla si,
dokumenta pronesie te pasurive te ndryshme te rregjistruara te luajtshme dhe te paluajtshme,
(nga Zyra Rregjistrimit te Pasurive te Paluajtshme, Qendra Kombetare e Rregjistrimit, Drejtoria
e Rregjistrimit te Automjeteve etj).

PADITES

Nenshkrimi i personit qe paraqet padine



SHËRBIMI LIGJOR FALAS TIRANË